



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

MISIONI NË KOSOVË

DEPARTAMENTI PËR MONITORIM

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

Raporti Muor – Dhjetor 2007

Gabimet në përkthim të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës shkelin parimin e sigurisë juridike dhe mund të rezultojnë në shkelje të parimit të ligjshmërisë

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) është i brengosur se gabimet në përkthim në gjuhë shqipe të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (“Kodi Penal”)¹ përbëjnë shkelje të së drejtës për siguri juridike dhe mund të rezultojnë në shkelje të parimit të ligjshmërisë.

Dispozitat ligjore që ndërlidhen me të drejtat e individit duhen të jenë në dispozicion në mënyrë adekuate dhe të formuluar me përpikëri të mjaftueshme në mënyrë që t’i sigurojnë individit që ai/ajo të rregullojë pjesëmarrjen e vet. Për këtë arsye, sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dispozitat ligjore të cilat përmbajnë vepra penale duhet të përpilohen në atë mënyrë që individit të njoftohet nga forma e shkruar e dispozitës relevante dhe nëse është nevoja edhe me ndihmë të interpretimit nga ana e gjykatës se cilat veprime dhe përjashtime mund ta bëjnë atë përgjegjës.²

Megjithatë, OSBE ka zbuluar raste në të cilat përkthimi në gjuhën shqipe i Kodit Penal dallon nga versioni në gjuhën angleze i cili mbizotëron në rast konflikti³:

Neni 297(1) i Kodit Penal dënon “Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik dhe rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve apo pasurinë me përmasa të mëdha dhe me këtë i shkakton [...] dëm thelbësor material që tejkalon vlerën 15,000 Euro [...]” Versioni në gjuhën shqipe thotë “1,000 Euro.” (theks i shtuar)⁴

Neni 208(3) i Kodit Penal, në versionin në gjuhën angleze, përcakton dënim të rëndë për veprën “bashkëjetesa me person nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçe në bashkësi jashtëmartesore” nëse vepra është kryer kundër personit “nën moshën katërmëdhjetë vjeçe.” Versioni në gjuhën shqipe thotë “nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçe.” (theks i shtuar)⁵

¹ Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/25 mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës e shpallur me 6 korrik 2003.

² Shih vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Kokkinakis v. Greece*, 14307/88, 25 maj 1993, paragrafi 52.

³ Neni 356 i Kodit Penal.

⁴ Shënim, nëse gjyqtari bazohet në versionin shqip të dispozitës, ai/ajo mund ta dënoj të pandehurin për shkaktim të dëmit në vlerë prej vetëm 1,000 Euro. Kjo do të përbënte shkelje të parimit të ligjshmërisë, pasi që versioni autoritar në gjuhën angleze dënon vetëm ata të cilët shkaktojnë dëme që tejkalojnë vlerën prej 15,000 Euro.

⁵ Kështu, në versionin shqip të nenit 208 nuk ka dallime në mes të paragrafit 1 dhe 3, pasi që të dytë përshkruajnë gjashtëmbëdhjetë vjet si moshë të viktimës. Kjo e bën të paqartë se cilin dënim (atë nën paragrafin 1 ose 3) gjyqtari duhet ta vendos.

Versioni në gjuhën angleze i Kodit Penal⁶ është autoritar,⁷ dhe procedura penale mund të zhvillohet në gjuhën angleze.⁸ Në çfarëdo rasti, banorët e Kosovës në mënyrë të arsyeshme pritet të mbështeten vetëm në versionet e ligjit në gjuhën shqipe apo atë serbe⁹ pasi që këto janë gjuhët e tyre amtare. Pasi që gjykatat dhe prokuroritë lokale shpesh nuk kanë përkthyes për gjuhë angleze, shqipe dhe serbe dhe shumica e zyrtarëve nuk kuptojnë anglisht, nuk mund të pritet nga gjyqtarët që ata t'i zgjidhin konfliktet gjuhësore.

Në përmbledhje, këto gabime gjuhësore jo vetëm që shkaktojnë pasiguri juridike por mund të rezultojnë edhe në trajtim jo të barabartë,¹⁰ ose në shkelje të parimit të ligjshmërisë.¹¹

Për atë çka u tha më lartë OSBE rekomandon që:

- Autoritetet relevante në UNMIK që janë përgjegjës për publikimin e Gazetës Zyrtare të UNMIK-ut, duhet të sigurojnë që versionet në gjuhën shqipe dhe serbe të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale të përputhen saktësisht me versionin zyrtar në gjuhën angleze.
- Gjyqtarët dhe prokurorët duhet ta zbatojnë versionin në anglisht të nenit 297(1) dhe 208(3) të Kodit Penal, deri sa nuk të përmirësohet përkthimi shqip i ligjit.

Gjykatat civile dështojnë që sipas detyrës zyrtare të vlerësojnë juridiksionin e tyre në përputhje me kërkesat ligjore

OSBE është e brengosur se gjykatat civile në Kosovë në disa raste kanë dështuar që sipas detyrës zyrtare të vlerësojnë kompetencën e tyre në rastet ku Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme lidhur me Çështjet e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (“dhoma e veçantë”) ka juridiksion primar ose ekskluziv. Kjo jo vetëm që përbën shkelje të ligjit vendor procedural por gjithashtu mund të shkel të drejtën për dëgjim nga gjykata e përcaktuar me ligj.¹²

⁶ Për më tepër, OSBE është e brengosur për përkthimin e pasaktë në gjuhën shqipe të disa dispozitave të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale (e shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/26, 6 korrik 2003, “Kodi i Procedurës Penale”). Për shembull, neni 306(5) në versionin anglisht të Kodit të Procedurës Penale thotë se kolegji i përbërë nga tri gjyqtarë do të “pyet” se ka arsye për paraburgim. Versioni në gjuhën shqipe thotë se kolegji do të “shikon” sipas detyrës zyrtare se ekzistojnë ende arsyet për paraburgim. Veç kësaj, neni 306(4) thotë se gjykata do të vendos “menjëherë” dhe jo më vonë se 48 orë. Fjala “menjëherë” nuk gjendet në versionin shqip.

⁷ Në bazë të nenit 356 të Kodit Penal, “Versionet në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe të ligjit në fjalë janë autentike në mënyrë të barabartë. Në rast konflikti, versioni në gjuhën angleze do të mbizotëroj.”

⁸ Neni 15(1), Kodi i Procedurës Penale.

⁹ Përkthimi në gjuhën serbe i të gjitha dispozitave të përshkruara është i saktë. Megjithatë OSBE nuk mund të përjashtojë rastin se mund të ketë gabime në përkthim serbisht të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

¹⁰ Varësisht nga ajo se a është gjykuar një i pandehur nga një gjykatë, anglisht-folëse, shqip-folëse apo serbisht-folëse, mund të zbatohen dispozita të ndryshme substanciale apo procedurale.

¹¹ Shih p.sh., futnotën 2.

¹² Shih nenin 14(1) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe nenin 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Sipas procedurës civile të aplikueshme, [m]enjëherë pas pranimit të padisë, gjykata duhet që sipas mënyrës zyrtare të vlerësojë se a është kompetente ta gjykojë atë rast të veçantë [...].”¹³ “Në raste kur gjatë procedurës gjykata përcakton se rasti nuk bie as brenda juridiksionit të gjykatës që e ka pranuar [...], por që bie nën juridiksion të ndonjë organi tjetër vendor ose të huaj, do ta shpall veten jo-kompetente, t’i anulojë veprimet e ndërmarra gjatë procedurës dhe ta refuzojë padinë.”¹⁴ Pasi që gjykata ta shpall vetën jo-kompetente, do të ja përcjell rastin gjykatës ose organit kompetent.¹⁵

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/13 mbi Themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, në seksionin 4.1 nënvizon juridiksionin primar të dhomës së veçantë. Kjo përfshin padi të ngritura kundër një ndërmarrjeje apo korporate që janë apo më parë kanë qenë nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Edhe pse dhoma e veçantë mund t’i përcjell paditë e veçanta në cilëndo gjykatë që ka kompetencën e kërkuar lëndore, “asnjë gjykatë në Kosovë nuk do ta ushtrojë juridiksionin e vet lidhur me padinë që përfshinë materien e përshkruar në seksionin 4.1 përveç në rastet kur padia e tillë i është referuar asaj [...].”¹⁶

Përkundër këtyre dispozitave të qarta, rastet në vijim demonstrojnë dështimin e gjykatave që ta vlerësojnë juridiksionin e tyre në mënyrë të duhur dhe të ua përcjellin rastet organeve kompetente.

Në një rast pronësor para një Gjykate Komunale kundër një ndërmarrjeje shoqërore e cila ishte nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, në seancën e mbajtur me 21 shkurt 2006 gjykata vendosi të zhvilloj procedurën pa e vlerësuar se a është kompetente.¹⁷ Gjykata caktoi seancën e parë të shqyrtimit kryesor me 7 mars 2006 dhe mori vendimin me 3 maj 2006.

Në një rast punësimi para një Gjykate Komunale kundër një ndërmarrjeje publike e cila ishte nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, gjykata mbajti katër seanca të gjykimit¹⁸ dhe rrjedhimisht morri vendimin i cili shkoi me ankesë pranë Gjykatës së Qarkut me 22 shtator 2005.¹⁹

¹³ “Vlerësimi lidhur me kompetencë bëhet mbi baza të ngritura në padi, dhe mbi baza të fakteve të njohura për gjykatën.” Shih nenin 15(1) dhe (2) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare 4/77 me amendamentet që kanë pasuar). Veç kësaj, gjatë tërë procedurës, gjykata duhet që sipas detyrës zyrtare të kushtojë vëmendjen se a bie zgjidhja e rastit nën juridiksionin e saj. Shih nenin 16(1) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

¹⁴ Neni 16(2) Ligjit mbi Procedurën Kontestimore. Në bazë të nenit 354(2) dhe (3) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, një vendim i cili është marr jashtë kompetencës së asaj gjykate përbën shkelje substanciale të procedurës si dhe bazë për ankesë kundër atij vendimi.

¹⁵ Neni 21(1) i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

¹⁶ Seksioni 4.2 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/13, mbi Themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, e shpallur me 13 korrik 2002. Në rastet kur lënda i është referuar një gjykate lokale nga ana e dhomës së veçantë, ankesë kundër këtij vendimi mund të parashtrohet vetëm para dhomës së veçantë. Shih Seksionin 4.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/13.

¹⁷ Në datën e njëjtë, gjykata vendosi që Agjencia Kosovare e Mirëbesimit duhet të njoftohet lidhur me rastin.

¹⁸ E datës 17 janar, 10 shkurt, 10 mars, dhe 4 maj 2005.

¹⁹ Deri me 14 janar 2008, rasti është ende me ankesë.

Në te dy shembujt, gjykatat nuk e vlerësuan si duhet kompetencën e tyre për të dëgjuar rastin. Pasi që të dyja rastet përfshinin padi kundër ndërmarrjeve që bien nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, gjykatat është dashur t'i refuzojnë paditë dhe t'i referojnë ato te dhoma e veçantë. Duke dëgjuar rastet që bien jashtë juridiksionit, gjykatat kanë shkelur ligjin vendor e mbase edhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.²⁰

Për atë çka u tha më lartë OSBE rekomandon që:

- Gjykatat duhen të vlerësojnë me kujdes kompetencën e vet para se të zhvillojnë procedurën për paditë ku përfshihen ndërmarrjet e pronës shoqërore në mënyrë që të sigurojnë të mos pranojnë raste të cilat bien nën juridiksion primar ose ekskluziv të dhomës së veçantë .
- Instituti Gjyqësor i Kosovës duhet të trajtojë gjyqtarët mbi juridiksionin e dhomës së veçantë.

²⁰ Shih, p.sh., neni 14(1) i Konventës Evropiane për të Drejtat Civile dhe Politike dhe neni 6(1) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku dhoma e veçantë kishte zgjedhur të ja referoj rastet gjykatës komunale, kompetenca e gjykatës ankimore ndryshon. Nëse dhoma e veçantë ka pasur juridiksion primar por e ka përcjell rastin në gjykatë lokale, vetëm dhoma e veçantë mund ta shqyrtoj ankesën. Ndryshe nga kjo, në raste kur gjykata lokale ka juridiksion primar, pala mund të parashetrojë ankesë pranë gjykatës së qarkut.